



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINE  
OPŠTINA KLINE



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KUVENDI I KOMUNËS  
KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA  
01. NR. 06-591  
KLINË, 16.1.2017

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT  
I MBLEDHJES SË KPF-së, MBAJTUR, MË 16.1.2017, NË ORËN 10:00, NË SALLËN E  
KK**

Në mbledhje prezantuan: Kryesuesi i KPF-se, Dr. Haxhi Ibishi, anëtarët e KPF-së, drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Ramiz Rrusta, Zyra ligjore, KFOR-i, OSBE, Zyra e Informimit, Zyra për Integrime Europiane, OJQ “Koha” etj.

Mbledhjen e udhëhoqi kryesuesi i KPF, Dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju uroj mirëseardhje në këtë seancë të KPF-së. “Materialin e keni marrë bashkë me rendin e ditës. “Kjo praktikë po na përcjellë, kam tri kërkesa nga ekzekutivi që i kemi marrë dhe kërkohet që t’i përfshijmë si pikë të rendit të ditës. Kërkesat kanë ardhur më 10.1.2017”, ka shtuar kryesuesi Ibishi.

**Dardan Bashota**, zyrtar i lartë i Drejtorisë së Urbanizmit, raportoi në mënyrë kronologjike rreth kërkesave të parashtruara për futje në rend të ditës të këtyre tri pikave: te Draft-rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave, të Planit komunal për menaxhim të mbeturinave dhe të Planit të Integritetit Komunal.

**Haxhi Ibishi**, tha se kërkesa është që për t’u vënë në rend të ditës.

**Fadil Gashi**: “Ju uroj sukses të gjithëve!” Po lidhem me materialin dhe ftesat: kisha bërë një propozim, le të jetë qysh ka qenë më herët. Le të na sjellin materialin fizik te dera. Nuk po dimë, ta marrim në kuti apo në adresën elektronike. Jemi mbetur as me kopje fizike, as me tjetrën. Për pjesën tjetër, nëse kompanitë private marrin para të majme, nuk di çfarë miratojmë pasi që asgjë nuk kemi përpëra. Po e humbim autoritetin si KPF. Të mos luajnë me ne! Ata po i marrin paratë, kështu që është shkelje e autoritetit të KPF-së”, shtoi ndër të tjera anëtarë Gashi.

**Haxhi Ibishi**, tha se pajtohem me këto konstatime, kjo është papërgjegjshmëri. Shërbimi për Punë të Kuvendit po ju çon drejtoreve datën, këtu po mungojnë. I vetmi prej drejtoreve që na ka përcjellë rregullisht ka qenë afër në mbledhjet e KPF-së është drejtori i Financave, z. Ramiz

Rrusta. Nuk mund të mos e nGRE shqetësimin, megjithatë votën e JAP aty ku e JEP partia që përfaqësoj”, shtoi Kryesuesi.

**Halil Desku:** “Urime pËR tË gjithë!” Janë disa vËREJTJE qË janë pËRSËRITUR, mirëpo me këtë rast kur jemi te kËRKESAT e DARDANIT mendoj ndryshe. Ju kisha lutar qË tË bËHENI pJESË e interesit komunal. Sikur tË ishte neglizhenca e drejtoreve pËRKATËSE dHE fajet janë tË EKZEKUTIVIT, ËSHTË çËSHTJE tjetër, mirëpo këto fajet janë diku tjetër, JON TE EKZEKUTIVI. Interesi i GIZ-it ËSHTË tË pËRFITOJË Klina. Pasi ËSHTË interes yni ju lus ta pËRFSHIMË nË rend tË ditës, sepse GIZ-i i ka datat dHE nuk na toleron. Ta vËMË nË rend tË ditës!” - shtoi prof. Desku.

**Ndue Shabanaj:** “Urime tË gjithëve pËR VITIN e RI 2017, me dËSHIRAT pËR SUKSASE! KËTO kËRKESA mund tË JENË tË ARSYESHME, mirëpo nuk mund tË JETË e PAARSYESHME tË SHQYRTOHEN nË rend tË ditës PA MATERIAL. NËSE kalimi nËPËR KPF ËSHTË formalitet, ËSHTË tjetër gjë. NË MUNGESË tË MATERIALIN NE NUK MUND tË MARRIM vendim. JEMI MARRË vesh edhe mË HERËT, PRANDAJ EDHE DUHET VENDOSUR”, tha prof. Shabanaj.

**Fadil Gashi**, tha se nuk po kËRKojmë pËR tË DALË jashtë LIGJIT pËR VETËQEVERISJEN LOKALE. “ÇFARË INTEGRITETI PO KËRKON KUR VETË e SHKEL. INTEGRITETI ËSHTË i QËNDRUESHËM KUR TI e RESPEKTON. NJË KOMPAÑI PRIVATE LUAN ME NE, PRANDAJ JAM KUNDËR”, tha anëtari Gashi.

**Skënder Merturi**, tha se po bëjmë thirrje pËR ZBATIM tË QËNDRIMEVE qË KEMI MARRË. “TË TREGOHEMI SERIOZË; t’i ZBATOJMË QËNDRIMET TONA, PO ASHTU EDHE LIGJET”, ka pohuar ndër tË tjera anëtari Merturi.

**Pal Berisha**, tha se i bashkëngjitëm diskutimeve tË PARAFOLËSVE. “PËR MUA AS BASHOTA, AS DESKU NUK NA KANË DHËNË FAKTE qË KËTO KËRKESA tË PËRFSHIHËN nË REND tË DITËS DHE PËR tË PROCEDUAR. ÇFARË DO tË THEMİ PA MATERIAL?! ËSHTË DUKURI qË PO NA PËRSËRITET VAZHDIMISHT. JAM PËR tË MOS U FUTUR nË REND tË DITËS”, theksoi anëtari Berisha.

**Haxhi Ibishi**, tha se mendimi im është me shumicën e juve, por vota ime është nga shkon ajo e PDK-së, mirëpo nuk po shoh qË kËRKESA do tË kalojë.

**Halil Desku**, tha se nuk do tË flas si shef i GRUPIT PARLAMENTAR tË PDK-së, por nË INTERESIN E QYTETARËVE. “DESHA tË FLAS pËR DIÇKA qË ËSHTË nË INTERESIN E QYTETARËVE DHE ËSHTË çËSHTJE URGJENTE. FAJI NUK ËSHTË i EKZEKUTIVIT DHE PO SHOH SE INTERESI ËSHTË YNI. NËSE ËSHTË LIGJORE E FTOJ ZYRTARIN E ZYRËS LIGJORE qË TA THOTË FJALËN. NËSE ËSHTË LIGJORE LE tË HYJË”, tha prof. Desku.

**Haxhi Ibishi**, tha se e kam pËR OBLIGIM qË KËRKESAT pËR t’i VËNË nË KPF, ju VENDOSNI. “TË MOS FUTET nË POZITA tË PALAKMUESHME KPF-JA”, tha Kryesuesi.

**Dardan Bashota**, dha sqarime shtesë rrëth kËRKESAVE.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi se po qË se hynë nË rend tË ditës këto pika shtesë tË RENDIT tË ditës, janë tri pika tË VËÇANTA tË RENDIT tË ditës.

**Fadil Gashi**, tha se sado që e zgjasim, na del diçka e re. “Do të kishte qenë mirë për të qenë drejtori, pa injoruar askënd. Ne veprojmë sipas Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale. Ata që kanë marrë punën prej GIZ-it luajnë me GIZ-in, po ashtu edhe me ne. Nuk po dyshoj në vullnetin e Komunës, por jo të punojmë përmendsh”, u shpreh anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, tha se kërkoj një seancë të jashtëzakonshme dhe për të vendosur para 28 shkurtit.

**Halil Desku**, tha se a mund të mbërrimë deri më 28 shkurt? “Po të ishte faji te Drejtoria e Shërbimeve Publike, mirëpo po e ripërsëris se faji nuk është te Komuna. Fola me zërin e arsyes. Ky material do të kalojë edhe në diskutim publik, dhe prapë në KPF, pastaj në AK, prandaj t'i zëmë këta hapa. Të bëhem i pjesë e përbashkët e votimit dhe të punojmë për një ambient të pastër”, tha prof. Desku.

**Fadil Gashi**, tha se nuk është mirë të na rreshton i që jemi për ose nuk jemi.

**Haxhi Ibishi**, tha se ky komitet ka qenë unikë në miratimin e shumë rregulloreve. “Këtu i kemi tri pika të rendit të ditës. E bëjmë një seancë të jashtëzakonshme, që procedurat do të mbërrin datën e 28 shkurtit. Nuk po dua që KPF-në ta sjell në situatë të ndarjes së votimit, e mbërrin seancën e shkurtit”, pohoi kryesuesi Ibishi.

**Fadil Gashi**, tha se edhe dy faqet e para duhet ndryshuar, këtu është më 2016, ndërsa tash veç jemi në vitin 2017.

KPF rekomandoi që për këto tri pika të thirret një seancë e jashtëzakonshme.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës.

**Me vota unanime u miratua ky**

#### **RENDI I DITËS:**

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi i Planit të Punës së KKSB,
4. Të ndryshme.

**Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.**

Kryesuesi sqaroi se nuk ka mungesa nga ana e anëtarëve të KPF-së.

**Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

Kryesuesi hapi debatin rrëth procesverbalit të seancës së kaluar.

**Fadil Gashi**, pati vërejtje në procesverbal. “Te fjala ime ku thuhet, Fadil Gashi pati vërejtje në diskutimin e tij”. Duhet të hiqet “në diskutimin e tij”, sepse unë nuk mund të kem vërejtje në diskutimin tim, prandaj të hiqet ajo pjesë, të mos mbetet në procesverbal”, tha anëtarë Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

**Me vota unanim e miratua procesverbali i seancës së kaluar.**

**Pika e tretë: Shqyrtimi i Planit të Punës së KKSBB.**

Kryesuesi foli rrëth rendit të ditës. Fjalën e barti te zyrtarja e lartë e Zyrës për Integrime Europiane, znj. Hava Thaqi.

**Hava Thaqi**, në mënyrë kronologjike foli rrëth Planit të Punës së KKSBB-së. “Rritja e sigurisë në shkolla dhe në afërsi të shkollave të mesme dhe fillore në Komunën e Klinës; ndriçimi i rrugëve në afërsi të shkollave me prioritet në fushën e rrezikshmërisë bazuar në vlerësim; ndriçimi i rrugës nga qyteti në drejtim të udhëkryqit Pejë – Prishtinë; vendosja e shkallëve emergjente; ndërtimi i trotuareve në afërsi të shkollave; ndërtimi i trotuareve në relacionin: Klinë – Deiq, Klinë – Videjë dhe Klinë – Krushevë e Vogël; vendosja e tabelave të emërtimit e rrugëve dhe shesheve; mbyllja e lokaleve në afërsi të shkollave të cilat nuk janë në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi; fushatë vetëdijesuese për parandalimin e dukurive negative (kundër drogës, duhanit dhe prostitutionit); sigurimi i vendparkimeve për autobusë që bartin nxënësit në afërsi të shkollave; hartimi i planeve të mbrojtjes nga zjarri nëpër shkolla; verifikimi dhe servisimi i aparateve të fikjes së zjarrit, si dhe trajnimi i stafit; vendosja e kontejnerëve për mbeturina në tërë territorin e Komunës (bazuar në Planin Komunal për menaxhimin e mbeturinave); regjistrimi i poseduesve të kafshëve dhe regjistrimi i kafshëve; trajtimi i qenve endacakë në Komunën e Klinës; vetëdijesimi i pronarëve për pasojat nëse nuk kujdesen për kafshët në pronësi të tyre; analiza e vendeve me rrezik për sigurinë publike dhe identifikimi i vendeve për zgjerimin e rrjetit të monitorimit me kamera: shëtitja përgjatë lumit Klina, rruga drejt Dresnikut, rruga deri në Videjë, vendosja e kamerave në brendinë e shkollave të mesme dhe fillore në qytet; vlerësimi i nevojave të stafit për Njësinë e zjarrfikësve; rritja e numrit të stafit të zjarrfikësve; vlerësimi dhe pajisja me mjetet e nevojshme për Njësinë e zjarrfikësve; ndërtimi i kapaciteteve të KKSP-së për edukim dhe parandalim të temave të ndryshme; rritja e komunikimit me komunitetet vlerësimi i nevojave për identifikimin e zonave të rrezikshme në trafik; organizimi i fushatave vetëdijesuese për rritjen e sigurisë në trafik dhe parandalimin e aksidenteve; projektet prioritare në buxhetin e Komunës; mirëmbajtja e hapësirës së varrezave të qytetit; vlerësimi i infrastrukturës dhe përmirësimi bazuar në vlerësim në një zonë të caktuar me prioritet dhe rrezikshmëri të lartë; vlerësimi i infrastrukturës dhe përmirësimi bazuar në vlerësim në një zonë të caktuar me prioritet dhe rrezikshmëri më të lartë, zgjerimi i rrugëve në drejtim të fshatrave; evidentimi dhe ndërmarrja e masave për lokacionet dhe projektet me rrezikshmëri të lartë (gropa në Volljak); vetëdijesimi dhe ndryshim të rregulloreve në respektim të definimit të qartë të secilit komunitet, përshtatja e infrastrukturës për plotësimin e nevojave të

personave me aftësi të kufizuar; raportimi i rregullt mbi gjendjen ekzistuese; bashkëpunimi me QPS përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të komuniteteve; forum në nivel komunal ku raportohet dhe vlerësohet gjendja e sigurisë në Komunë”, ka konstatuar zyrtarja Thaqi.

Kryesuesi hapi debatin rrith Planit të Punës së KKSBB-së.

**Pal Berisha**, tha se mosprania kryetarit të Komunës është e pajustifikueshme, se edhe zonja Thaqi e tha se nuk posedon me të gjitha të dhënat. Në vazhdim anëtarë Berisha kërkoj disa sqarime: “Këtu për qentë endacakë, sa janë shpenzuar dhe sa planifikohet përmirësimin e tyre? Për sigurinë në trafik, ky këshill, a nuk e ka parë të rrugës shënimin e kalimit të rrugëve afér Shkollës së Mesme Teknike, Qendrës së regjistrimit, Xhamisë, ku frekuentimi i njerëzve është i madh”, tha anëtarë Berisha.

**Fadil Gashi**, tha se përmospjesëmarrje në këtë mbledhje shkon për Kryetarin, po që se është bartës i këtij plani. “Nuk po e dimë faktin se a mund të implementohet ky plan. Po e shoh se kostoja del 70 300 euro. Ne nuk e kemi në miratim të buxhetit, a do të jetë në gjendje Drejtoria e Financave për t’i siguruar këto mjete. Ligji përcakton numrin e stafit, sikur te mjetet, për numër të banorëve. Ky plan është ndërtuar mbi bazën e copy pastë. Kërkesa ime është që të zgjerohet sigurimi. Po ashtu edhe mirëmbajtja e varrezave, të përcaktohet për cilat varreza bëhet fjalë. Në varrezat e Zajmi më keq nuk shkon. Të bëhet një plan të varrimit. Do të ketë problem të mëtutjeshëm. Ne dimë për gropën në Vollajk, prandaj çfarë do të veprojmë. Të gjithë e dimë që është aty dhe lahen në të. Për fat të mirë që nuk kemi pasur humbje në njerëz. Çka për t’i bërë atij uji, kur buron etj.,” shtoi ndër të tjera anëtarë Gashi.

**Skënder Merturi**, tha se vërehet që ky plan është kopje. “Në faqe 1 shkruan 2011-2016, tash jemi në 2017. Janë bërë përshkime të planeve të kaluara. Nuk është bërë dicka e re. Për çdo kritikë, e para, nën kryetari është dashur që të marrë pjesë në mbledhje dhe të shpjegojë çka është arritur dhe çka do të arrihet në të ardhmen. Varrezat e dëshmorëve janë në gjendje të mjerueshme, prandaj duhet të kërkohet rregullimi i tyre. Le të përmirësohet përmirësohet për varrezat e dëshmorëve”, shtoi ndër të tjera anëtarë Merturi.

**Ndue Shabanaj**, tha se ky material mua më mungon, s’ë posedojoj. “Nën kryetari i ka përgjegjësitë dhe ishte dashur të jetë këtu. Ky plan ishte dashur që të sqarohet nga ai. Unë s’ë kam materialin. Të jemi më seriozë. Kjo është e patolerueshme”, shtoi prof. Shabanaj.

**Haxhi Ibishi**, tha se Kosova është duke shkuar në me një dinamizëm, administratat s’po e kryen punën që i takon. Në këtë rast, ai që është përgjegjës mungon. Nuk e thërras seancën e jashtëzakonshme në qoftë se ekzekutivi nuk është i interesuar.

Kryesuesi vuri në miratim rekondimin përmirësimin për shqyrtim dhe miratim në KK.

**Me vota unanim e miratua rekondimi.**

Kryesuesi falënderoi anëtarët përmirësimin për kontributin e dhënës.

Mbledhjen e konstatoi të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel GOJANI

*mikel gojani*

